

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGETISE DHE ENERGJITIKES
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike ✓

U R D H E R

Nr. 69 Date 25.01.06

PER

NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A. "KRIPA"

VLORE


Drejtuar : Sh.A. "KRIPA" VLORE

Ne mbeshetetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe neni 128, 150 te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare, me cilesine e aksionerit te vetem .

URDHEROJ:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet per vleren 12 007 569 000 leke, e barabarte me 12 007 569 aksione me vlore nominale 1000 leke per aksion, qe i perkasin privleresimit te truallit dhe kalimit te rezervave ne kapital.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A. "Kripa" Vlore, behet **17 167 569 000 leke** i barabarte me 17 167 569 aksione me vlore nominale 1000 leke per aksion.
Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.


MINISTRI
GENC RULI

28.05.2003
Per zbatim Dregjoria
i vendit Nr 169 date 13.03.2003



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË**

Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla dhe të Mesme

URDHËR

Nr 204 Datë 22.5.2003

PËR

**RIVLERËSIMIN E TRUALLIT TË SHOQËRISË ANONIME "KRIPA" SH.A.
VLORE**

Drejtuar: Shoqërise Anonime "Kripa" sh.a. Vlore

Duke marre parasysh kërkesat ligjore dhe proceduriale të vleresimit të elementeve të pasurisë së shoqërisë, në zbatim të vendimit nr.169, datë 13.03.2003 të Këshillit të Ministrave,

KONSTATOVA

Se në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 8885, datë 22.04.2002 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, ndryshuar me akte të tjera ligjore"; Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare"; në zbatim të Vendimit Nr.169, datë 13.03.2003 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe procedurat e vleresimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore që u nënshtrohen privatizimit apo transformimit të tyre në shoqëri tregtare" dhe Vendimit Nr.119 datë 27.02.2002 të Këshillit të Ministrave" Pika 7, paragrafi i parë, duhet të bëhet rivlerësimi i truallit të shoqërisë.

Përsa me sipër, në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, me cilesinë e zotëruesit të aksioneve të shoqërisë,

URDHËROJ:

1. Të rivlerësohet trualli i shoqërisë "Kripa" sh.a. Vlore në zbatim të Vendimit Nr.169, datë 13.03.2003 të Këshillit të Ministrave.
2. Znj. Albina Manaj dhe Z. Namik Vehipi eksperte kontabel të autorizuar të përgatisin raportin e zmadhimit të kapitalit në përputhje me piken 1 të këtij urdhëri.
3. Ngarkohet drejtoria e shoqërisë "Kripa" sh.a. Vlore për zbatim.


Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

Dale nga arkiva e SH.A. Kripes.

Q/Personeli

Merymthi Meksi

Meksi



(2)

**RAPORT I VEÇANTË I
EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR
“ MBI ZMADHIMIN E KAPITALIT TE KRIPA SH.A “**

Me cilësinë tonë, si ekspert kontabël të autorizuar, sipas kërkesave të ligjit nr. 7638 dt. 19/11/1992 “ Për shoqëritë tregëtare “, po i'u paraqesim Raportin e veçantë, për zmadhimin e kapitalit, si rezultat i rivlerësimit të truallit, të shoqërisë **Kripa sh.a**, në zbatim të vendimit nr. 169 dt. 13/3/2003 të Këshillit Ministrave dhe Urdhërit nr. 204 dt. 22/5/2003 të Ministrisë Ekonomisë.

Për kryerjen e këtij misjoni, nga ana e jonë, është proceduar sipas V.K.M dhe Udhëzimit të dalë, për rivlerësimin e truallit, duke filluar nga krijimi i komisioneve deri në miratimin e çmimit mezatar të truallit, në evidentimin e saktë të sipërfaqeve.

Projekti i zmadhimit të kapitalit, llogaritur nga ana jonë, evidenton operacionin e zmadhimit të kapitalit, si rezultat i rivlerësimit të trojeve të shoqërisë qe, sipas akt-vlerësimit të lëshuar nga Drejtoritë e Financave të Bashkisë Vlorë dhe Komunës Novoselë, të konfirmuara nga Urbanistika, rezulton :


- Sh.A Kripa në zon. e Vlorës : $m^2 66.250 \times 1.230 = 81.487.500$ lekë
- Sh.A Kripa në zon. Cerkl. : $m^2 15.221.900 \times 1.100 = 16.744.090.000$ “
- S h u m a : 16.825.577.500 “**

Në bilancin e vitit 2002 vlera e truallit të shoqërisë regjistohet për shumën lekë 4.871.008.000, kështu që : diferenca prej 11.954.569.500 lekë përbën shumën e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë **Kripa sh.a**, nga rivlerësimi i truallit (16.825.577.500 - 4.871.008.000).

Në se operacioni i zmadhimit të kapitalit, të shoqërisë, realizohet sipas projektit të paraqitur, nga ana e jonë, atëhere :

- Kapitali i Kripa sh.a nga vlera prej 5.160.000.000 lekë para operacionit, të ndarë me : 5.160.000 ~~lekë~~ aksione - me vlerë nominale 1000 lekë- , do të zmadhohet për 11.954.569.000 lekë duke mbërritur, pas operacionit, në 17.114.569.500 lekë, e , nëse do të ruhet vlera e një aksioni prej 1000 lekë, atëhere do të formulohen 17.114.569 aksione, duke u shtuar me 11.954.569 aksione.

[Signature]



Operacioni I zmadhimit të kapitalit nuk cënon të drejtën e pronësisë e cila është e aksionerit të vetëm, Ministria e Ekonomisë.

Me zmadhimin e kapitalit, të shoqërisë, sipas urdhërit nr. 204 dt. 22/5/2003 të Ministrisë Ekonomisë, kapitali I ri I shoqërisë rezulton 17.114.569.500 lekë, ndryshim që duhet të pasqyrohet në regjistrin tregëtar të Gjykatës Tiranës.

Rekomandojmë që : zmadhimi I kapitalit të shoqërohet me ndryshimet dhe në statutin e shoqërisë.

EKSPERTËT KONTABËL AUTORIZUAR

NAMIK VEJTI
NAMIK VEJTI KONTABËL
ALBINA MANAJ KONTABËL
MINISTRIA E FINANCËVE
VLORA - ALBANIA
PAMVARSIJA 112
TEL. 069-22889



Handwritten signature

•

OBJEKT I MISSIONIT


Vleresimi i elementeve te aktivitet dhe I pasivitet bazuar ne vlerat kontabel te bilancit date 31 12 2004 per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise SHA "KRIPA"
VLORE

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR Violeta Haloci

Kapitali themeltar	5 160 000 000 leke
--------------------	--------------------

Selia e shoqerise	VLORE
-------------------	-------

Tirane 30 Qershor 2005



**RAPORT PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR
NEPERMJET KALIMIT TE REZERVES SE RIVLESESIMIT,
REZERVAVE TE TJERA DHE REZERVAVE TE KRIJUARA NGA
SHPERNDARJA E FITIMIT TE VITIT 2004 GHITHASHTU RITJA E
KAPITALIT NGA RIVLKERESIMI I TRUALLIT.**

Une Violeta Haloci eksperte kontabel e autorizuar me nr license 83 caktuar me shkrese te Ministrise Ekonomise Tirane nr. 2870 date 06 05 2005 ne lidhje me shtimin e kapitalit te shoqerise .

Per te kryer misionin tim u mbeshteta ne kete dokumentacion:

- Ne shkresen nr. 2870 date 06 05 2005 te Ministrise Ekonomise
- Ligji 7638 date 19 01 1992 "Per shoqerite tregetare "
- Ligji nr 8237 date 01 09 1997 per disa ndryshime ne ligjin nr 7926 date 20 04 1995 " Per transformimin e ndermarjeve shteterore ne shoqeri tregetare" ndryshuar me Dekretin nr 1195 date 14 08 1995.
- Bilanci financiar per vitin ushtrimor 2004 mbyllur ne 31 12 2004
- Raporti I eksperteve kontabel te autorizuar
- Miratimin e bilancit te vitit ushtrimor 2004 nga aksionieri I vetem shtet.
- Bilancin e reformuar per ndyshimin e kapitalit pas per rivleresimit te truallit sipas VKM nr 169 date 13 03 2003 miratuar nga ekspertet kontabel te autorizuar sipas Urdherit te Ministries Ekonomise nr 204 date 22 05 2003
- Raporti I eksperteve kontabel te Autorizuar
- Statusi I shoqerise si dhe gjithe dokumentacioni perkates.

Me vendimin nr 23818 date 16 05 2000 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte krijuar shoqeria SHA " KRIPA " Vlore,. Gjate periudhes nga krijimi I saj e deri ne 31 12 2004 shoqeria te regjistruar ne gjykate ka nje kapital themeltar prej 5 160 000 000 leke te ndare ne 5 160 000 aksione me vlere nominale 1000 leke./aksioni. Aksioner I vetem I shoqerise eshte shteti, Ministria e Ekonomise.

1 OPINIONE PER VLERESIMIN E AKTIVIT

Ne baze te ekzaminimit kontabel per aktivet e qendrueshme te trupezuara te pasqyruara ne bilanc per vleren neto kontabel 4 992 660 974 leke bazuar ne dokumentacionin kontabel te shoqerise, rezultoi se ato jane te pasqyruara ne kontabilitet me vleren historike dhe vlere e inventarit kontabel te kryer nga shoqeria me 31 12 2004 perputhet me ate te pasqyruar ne bilancin perkates por



duhet te theksojme (se ne zerin trualli kemi shtuar vleren e rivleresuar te tij sipas VKM 169 date 13 03 2003 dhe sipas Urdherit te Ministrit te Ekonomise z. Anastas Angjeli nr. 204 date 22 05 2003. Ky rivleresim nuk eshte pasqyruar ne bilancin e vitit 2004 sepse nuk ka dale vendimi I gjykates por meqenese jane kryer te gjitha procedurat e rivletresimit kjo duhet te meret si baze ne aktivet e kapitalit per ndryshimin e tij. si vijon

Emertimi	Bilanci I Vitit 2004	Bilanci me shtesen e Rivleresimit te truallit
Toka , terrene, Troje	4 871 008 000 leke	16 825 577 000 leke
Ndertesa	53 699 889 leke	53 699 889 leke
Ndertime e instalime	194 904 177 leke	194 904 177 leke
Makineri e paisje	197 664 567 leke	197 644 567 leke
Mjete transporti	33 891 572 leke	33 891 572 leke
Inventar ekonomik	3 710 361 leke	3 710 361 leke
Totale vlera kontabel bruto	5 334 878 566 leke	17 289 447 566 leke
Amortizimi I akumuluar	362 217 592 leke	362 217 592 leke

Per verifikimin dhe vleresimin e tyre u bene sondazhe me dokumentat kontabel sipas elementeve dhe klasifikimit te tyre dhe rezultoi se ato ekzistojne fizikisht dhe jane prone e shoqerise ndaj vlera kontabel neto merret ne konsiderate per zmadhimin e kapitalit pasi ajo perben nje aktiv real per shoqerine.

Ne postin e bilancit gjendje inventari dhe ne proces ne shumen 208 461 912 leke perfshihet gjendja e materialeve ne magazine ne date 31 12 2004 e cila perputhet me gjendjen kontabel dhe me inventaret fizike te saj ne shumen 6 008 385 leke . Gjendja e produktit te gatshem ne shumen 200 830 299 leke , gjendja e inventarit ne shumren 3 246 452 leke me nje zhvleresim te tyre ne shumen 1 623 224 leke Gjendja e inventarit dhe ne proces eshte e kuadruar me kontabilitetin dhe bilancin. Per kete kjo perben nje aktiv real te shoqerise per shtese ne kapitalin themeltar.

Ne postin e bilancit kerkesa per arketim mbi debiteret vlera prej 117 279 238 leke ne baze te verifikimeve qe ne kryem rezulton se vlera e pasqyruar ne bilancin ushtrimor 2004 rakordon me inventarin kontabel te llogarive perkatese.

Vlera e pasqyruar ne postin kerkesa per arketim mbi denbitoret per shumen 117 279 238 leke mbeshetet ne dokumenta kontabel te rregullta ndaj ajo eshte ne vlere pasurore aktuale per shoqerine ne momentin e vleresimit per zmadhimin e kapitalit themeltar.



Nga kontrolli I kryer ne rubriken e bilancit likujditete dhe vlera te tjera arke te pasqyruar ne bilancin perkates per 24 339 723 leke rezulton se ajo perputhet me ekstrakte kontabel perkatese me 31 12 2004 si vijon:

Depozita ne banke dhe llogari te tjera	24 243 952 leke
Para ne dore { arke }	95 771 leke

Si konkluzion likujditetet qe rezultojne gjendje ne 31 12 2004 perbejne nje aktiv real per shoqerine.

Ne perfundim per efekt te zmadhimit te lkapitalit te shoqersie vlera e aktivitet real qe duhet te merret ne konsiderate rezulton



-Vlera e aktivitet totale 31 12 2004	5 342 741 847 leke
-Vlera e aktivitet fiktiv	nuk rezulton
-Vlera e aktivitet real	5 342 741 847 leke

2 OPINIONE MBI PASIVIN E BILANCIT

Ne kapitalet e veta te shoqerise vlera per 5 327 821 653 leke perfaqeson kapitalet e veta te cilat perbehen nga vlera e

-Kapitalit themeltar	5 160 000 000 leke
Ⓢ-Rezerva e rivleresimit	19 108 361 leke
Ⓢ-Rezerva ligjore	1 413 225 leke
Ⓢ-Rezerva te tjera	22 774 533 leke
- Fitimi I vitit ushtrimor 2004	13 597 696 leke
- Subvencione per investime	1 994 420 leke
Ⓢ- Provizione per shpenzime	108 933 418 leke

Ne verifikimin e kryer per kapitalet e veta te shoqerise rezulton se ne zerin rezerva perfshihen rezervat ligjore ne shumen 1 413 225 leke, rezerva rivleresimit ne shumen 19 108 361 leke dhe rezerva te tjera ne shumen 22 774 533 leke shuma keto qe jane krijuar nga shperndarja e fitimit te akumuluar. dhe rezerva e rivleresimit eshte krijuar ne kohen e krijimit te shoqerise mbas transformimit te ndermarjes, shuma prej 108 933 418 leke qe perfaqeson provizione per shpenzime eshte krijuar per debitorët ne persona te pasqyruar ne aktivin e bilancit. Gjithë bilancet jane te miratuara nga Keshilli Mbikqyres dhe Aksionieri I vetem shtet Ministria e Ekonomise dhe nga eksperte kontabel. te autorizuar. Gjithashtu fitimi I vitit ushtrimor me shkresen e Ministrise se Ekonomise eshte shperndare dhe



rezervat e tjera qe krijohen nga ky fitim jane vendosur te kalojne ne kapital. Shperndarja e ketij fitimi eshte sistemuar ne bilancin e reformuar.

Ne verifikimin e kryer ne rubriken e bilancit detyrime ne vlere 14 920 194 leke rezulton se ajo perbehet nga detyrime deri ne nje vit.

Ne kete post detyrime deri ne nje vit pasqyrohen detyrimet qe ka shoqeria me 31 12 2004 te cilat jane te njohura nga shoqeria dhe te pagueshme.

3 ZMADHIMI I KAPITALIT TE SHOQERISE

Behet realizuar nepermjet kalimit te rezerves se rivleresimit ne shumen 19 108 361 leke dhe rezervave te tjera ne shumen 34 332 574 leke gjendje ne 31 12 2004 sipas bilancit bazuar ne shkresen e Minbistrise Ekonomise per shperndarjen e fitimit te vitit ushtrimor 2004, leke Pra kapitali I neneshkruar nga shuma 5 160 000 000 leke behet 5 213 000 000 leke por duke mare per baze rivleresimin e truallit sipas urdherit te Ministrit te Ekonomise z. Anastas Angjelit nr 204 date 22 05 2003 realizuar sipas VKM 169 date 13 03 2003 ne bilancin e reformuar te miratuar nga ekspertet kontabel te Autorizuar. Kapitali I neneshkruar behet nga 5160 000 000 leke ne 17 167 569 000 leke duke shtuar vleren prej 11 954 569 000 leke diferenca e rivleresimit te truallit.

Duke patur parasysh se kam permbushur misionin tim per vleresimin e aktiveve dhe pasiveve te shoqerise bazuar ne vlerat e bilancit date 31 12 2004 vertetojne se llogarite kontabile shprehin vleren pasurore reale te shoqerise qe perfaqesohet nepermjet kapitalit te saj themeltar.

Si konkluzion kapitali themeltar I shoqerise nga shuma prej 5 160 000 000 leke I ndare ne 5 160 000 aksione me 1000 leke vlere e nje aksioni, me vleresimet tona bazuar ne legjislacionin perkates kapitali themeltar behet 17 167 569 000 leke. I ndare ne 17 167 569 aksione me nga 1000 leke aksioni.

Bashkangjitur ketij relacioni eshte dhe bilanci per percaktimin e vleres se zmadhimit te kapitalit themeltar.

4 PJESMARRJA ME KAPITALIN E SHOQERISE

Pas zmadhimit te kapitalit te shoqerise pjesmarja ne kapital rezulton si vijon:

Aksionieri	Numuri I aksioneve	vlera kapitalit Themeltar	%	vlera aksiomnit
1	17 167 569	17 167 569 000	100	1000

Ky mision I zmadhimit te kapitalit u krye ne baze te kerkeses se aksionietit te vetem shtet Ministria

EKSPELTE KONTABEL

Violeta Haloci

